



KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 70, dt. 03.04.2015

Në mbështetje të nenit 32 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 03. 04.2015, pasi shqyrtoi propozimet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit për shpalljen e zonës së mbrojtur të monumenteve “Ura e Katiut”, Bënjë, Përmet dhe të Vendbanimit Shpellor, Bënjë, Përmet.
2. Miratimin e propozimit për shpalljen e zonës së mbrojtur të monumentit “Kisha e Shën Mërisë, Bënjë, Përmet.
3. Miratimin e propozimit për shpalljen e zonës së mbrojtur të monumentit “Mulliri i Drithit” pranë fshatit Bënjë, Përmet.
4. Miratimin e propozimit për shpalljen e zonës së mbrojtur të monumenteve Kisha e Shën e Premtes Pogon, Gjirokastrë dhe Kroi i Selckës (Çezma me Kupolë), Pogon, Gjirokastrë.
5. Miratimin e propozimit për shpalljen e zonës së mbrojtur të monumentit Kisha e Shën Mëhillit, Gjirokastrë.
6. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI